

NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës personeli administrativ në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

“Mirëmbajtës” në Sektorin e Shërbimeve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Mirëmban ambjentet mësimore dhe jo mësimore, konstatimin dhe riparimin e dëmeve për mirëfunksionimin e punës në institucion.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas shqiptar/e;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetsore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit etiko- profesional me kolegët dhe eprorët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna” ;
- Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

Kritere të veçanta që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të ketë mbaruar minimalisht arsimin e mesëm.
- Eksperienca të mëparshme të punës në fushën e kërkuar përbën avantazh.
- Preferohet të jetë banor në qytetin e Vlorës.

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti. Gjetet në adresën www.univlora.edu.al ;
- Jetëshkrim/ CV;
- Diploma e shkollës së mesme (kopje e noterizuar);

- Libreza e punës (originale ose kopje të noterizuar);
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dokument origjinal i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor);
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;

Shënim:

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:

- **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë,
Lagjja. “Pavarësia”, Rr. “Kosova” 9400
Vlorë, Shqipëri.**
- **Drejtorja e Komunikimit dhe Burimeve
Njerëzore**
- **Për pozicionin: “Mirëmbajtës” pranë Sektorit
të Shërbimeve në Drejtorinë e Shërbimeve
Mbështetëse**

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 14.06.2021 dhe afati përfundon në datën 29.06.2021.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 29.06.2021, do t’i kthehet aplikantit pa veprime.

D R E J T O R

ELOINA TOZAJ